

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6454
E martë, 2 nëntor 2021
çmimi 0.40 €

Krasniqi e njofton
presidentin e NDI-së për
rezultatit e PDK-së në
zgjedhjet e 17 tetorit



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI SHKETËROR I ZGJEDHJEVE NË MAQEDONINË E VERIUT KA SHPALLUR
REZULTATET PRELIMINARE TË RAUNDIT TË DYTË TË ZGJEDHJEVE LOKALE

VMRO-DPMNE DHE BDI-ja, FITUESE TË ZGJEDHJEVE LOKALE NË MAQEDONI



Edhe në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut ka dalë fituese partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE. Sipas rezultateve preliminare të këtij raundi, kjo parti ka fituar 20 prej 44 komunave sa është votuar në balotazh. Te partitë shqiptare fitore ka shënuar Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), duke fituar shtatë komuna. Lëvizja Besa ka fituar në dy komuna, ndërsa Aleanca për Shqiptarët ka fituar në Gostivar

AKTUALE



LUFTË E ZBEHTË NDAJ
DEZINFORMATAVE PËR VAKSINIM
NË KOSOVË F.3

NË PERIUHDHËN JANAR - TETOR U
REALIZUAN 342 OPERACIONE NË
KLINIKËN E NEUROKIRURGJISË F.7

TË HËNËN E ARDHSHME
MBLIDHET KUVENDI F.7

DISKUTOHET PËR ZBATIMIN E
LIGJIT PËR PËRGJEGJËSINË
DISIPLINORE TË GJYQARËVE F.6

EKONOMI



KURTI PRET NË TAKIM
PËRFAQËSUESIT E NDI-së:
EKONOMIA JONË DO TË RRIET
PËR 9.9 PËR QIND F.8

ODAT EKONOMIKE KËRKOJNË
NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN
PËR TREGTI ME JASHTË F.8

SPORT

KOK-u DËRAGON NË KON
ANKESËN PËR REFUZIMIN QË
SERBIA I BËRI DELEGACIONIT
TË BOKSIT F.10

ZPS-ja URDHËROHET
QË DERI MË 17
DHJETOR TA DORËZOJË
DOSJEN PARAPRAKE
NË RASTIN E
ISH-KRERËVE TË UÇK-së



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ceremonia e Nobelit për Paqe do të mbahet në dhjetor

OSLO, 1 NËNTOR - Ceremonia e prezantimit të Çmimit Nobel për Paqe do të mbahet në Oslo më 10 dhjetor, ka njoftuar të hënën Komiteti i Nobelit. Vendimi ka ardhur pasi ceremonitë për çmimet e tjera Nobel që organizohen në

Stokholm janë anuluar për të dytin vit me radhë për shkak të pandemisë së koronavirusit. Komiteti Norvegjez i Nobelit ka thënë se pret që dy laureatët e këtij viti, gazetarja filipine Maria Ressa dhe Dmitry Muratov, kryeredaktor i të përditshmes

ruse, "Novaya", të marrin pjesë në ceremoni.

Përveç tyre, edhe udhëheqësi i Programit të Kombeve të Bashkuara për Ushqim, David Beasley, do të marrë pjesë në ceremoni.

Kjo agjenci ka fituar Çmimin

Nobel për Paqe më 2020, mirëpo ceremonia në Oslo ishte anuluar.

Fituesit e çmimeve të tjera Nobel do t'i pranojnë medaljet dhe diplomat në vendet e tyre, kanë bërë me dije organizatorët në shtator.



Australia heq kufizimet për udhëtime ndërkombëtare për herë të parë në pandemi



CANBERRA, 1 NËNTOR - Australia ka hequr të hënën kufizimet për udhëtime ndërkombëtare për herë të parë prej shpërthimit të pandemisë së koronavirusit, duke ua mundësuar personave të vaksinuar që të bashkohen me familjet e tyre.

Pas më shumë se 18 muajve të politikave më të ashpra në botë ndaj pandemisë, miliona australianë tani janë të lirë për të udhëtuar pa leje apo pa nevojë që t'i nënshtrohen karantinës kur të kthehen në

Australi.

Pasagjerët e udhëtimeve nga Singapori dhe Los Anxhelos kanë arritur në Sidnej në mëngjesin e së hënës, të mirëpritur nga familjarë dhe miq që nuk i kanë parë për disa muaj. "Pak me frikë dhe gëzim kam ardhur në shtëpi për ta takuar nënën, sepse ajo nuk është mirë", ka thënë Ethan Carner që ka udhëtuar nga Los Anxhelosi.

Kufizimet e ashpra për 18 muaj ua kanë pamundësuar australianëve që të marrin

pjesë në organizime të ndryshme, përfshirë dasma dhe funerale, si dhe u janë pamundësuar takimet me familjarë dhe shokë.

Ndonëse përhapja e variantit "Delta" të koronavirusit ka mbajtur nën izolim Sidnej dhe Melbërnin për disa muaj, numri i të infektuarve me koronavirus në Australi është shumë më i vogël sesa i vendeve të tjera.

Deri më 31 tetor autoritetet australiane kanë regjistruar 170 500 persona të infektuar dhe 1 743 viktima.

Polonia regjistron më shumë se 700 tentime për ta kaluar kufirin nga Bjellorusia

VARSHAVË, 1 NËNTOR - Policia kufitare polake ka regjistruar më shumë se 700 tentime për të kaluar ilegalisht kufirin Poloni - Bjellorusi në 24 orët e fundit, ka njoftuar shërbimi kufitar.

Ndërkohë Polonia vazhdon të refuzojë që t'ua mundësojë punëtorëve shëndetësorë joqeveritarë, që të kujdesen për migrantët e bllokuar nëpër kufi.

Rojet kufitare kanë ndaluar katër të huaj, të gjithë qytetarë irakianë, nga 727 tentime në total, ka raportuar një radio polake.

Bashkimi Evropian akuzon liderin e Bjellorusisë, Alyksandr Lukashenka, se po shtyn migrantët drejt kufijve të bllokut evropian, si

hakmarrje ndaj sanksioneve të Brukselit.

BE-ja ka vënë sanksione ndaj këtij shteti për shkak të shtypjes që i është bërë opozitës, shoqërisë civile dhe mediave të pavarura, prej mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020, të cilat janë konsideruar të manipuluar.

Më herët gjatë kësaj jave Polonia ka bërë me dije planet për ta rritur numrin e ushtarëve dhe rojeve në kufi me Bjellorusinë.

Gjermania, po ashtu, ka thënë se do të angazhojë qindra zyrtarë policorë shtesë në kufi me Poloninë, për të ndihmuar për krizën e migrantëve, të cilët kryesisht shkojnë atje përmes Bjellorusisë.



Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë infektohet me Covid

UASHINGTON, 1 NËNTOR - Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Jen Psaki, ka bërë me dije se është infektuar me Covid-19. Ajo ka thënë se për herë të fundit është takuar me presidentin Joe Biden, të martën që lamë pas. Psaki,

42-vjeçare, ka treguar se gjatë takimit me Bidenin ishin larg njëri-tjetrit 1.8 metra dhe mbanin maska. Burime brenda Shtëpisë së Bardhë kanë bërë me dije se presidenti Biden ka dalë negativ në testin për Covid-

19.

Psaki vendosi të mos i bashkohet presidentit Biden në udhëtimin e tij në Romë dhe Glasgow këtë javë, sepse një anëtar i familjes së saj doli pozitiv në testin për virusin dhe për këtë arsye ajo hyri në

karantinë. Ajo është në karantinë që nga e mërkura dhe në mënyrë të përsëritur doli negative përpara se të dalë pozitive në testin për Covid-19 të dielën. Psaki planifikon të kthehet në punë pas karantinës dhjetëditore.



Luftë e zbehtë ndaj dezinformatave për vaksinimin në Kosovë



Ministria e Shëndetësisë: Besoni në fakte dhe vaksinohuni

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se që nga fillimi i fushatës së vaksinimit janë ofruar të dhëna mbi vaksinat, oraret e vaksinimit dhe thirrjet e vazhdueshme për vaksinim. Kjo ministri, po ashtu, ka thënë se në bashkëpunim me mediat ka përcjellë te publiku vetëm të dhëna të konfirmuara shkencërisht lidhur me vaksinimin.

Duke u bërë thirrje qytetarëve për vaksinim, kjo ministri thotë se informacionet më të përditësuara mund të gjenden në kanalet e komunikimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Në përgjigje thuhet, po ashtu, se "Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë e angazhuar nga fillimi vetëm në kontraktimin e vaksinave që janë të regjistruara në EMA (Agjencia Evropiane e Barnave) dhe FDA (Agjencia Federale e Barnave), të cilat janë dëshmuar në siguri dhe efikasitet".

Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se ka sasi të mjaftueshme të vaksinës kundër Covid-19 dhe se të gjitha janë të sigurta dhe efektive. Në Kosovë, aktualisht, qytetarët imunizohen me dy vakcina kundër koronavirusit, "Pfizer" dhe "AstraZeneca".

S'ka interesim për vakcina

Që prej nisjes së imunizimit me vaksinë kundër koronavirusit, gradualisht bota ka filluar t'i kthehet normalitetit. Ndërsa në Kosovë numri i rasteve të reja me Covid-19 ka rënë javët e fundit. Bashkë me këtë ka rënë edhe numri i të vaksinuarve. Derisa në muajin gusht brenda ditës vaksinoheshin rreth 20 mijë qytetarë, në javët e fundit numri i të vaksinuarve brenda 24 orëve është shumë më i vogël.

Në pesë ditët e fundit të tetorit janë vaksinuar gjithsej 23 259 qytetarë. Në total në Kosovë, që nga muaji mars i këtij viti, kur ka filluar procesi i vaksinimit, mbi 840 mijë qytetarë janë vaksinuar me dozën e parë, derisa të dyja dozat i kanë marrë më shumë se 724 mijë qytetarë.

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Arianit Sllamnikut nga Gjilani ka disa ditë që i është mbyllur llogaria në "Facebook" si pasojë e postimeve të shpeshta kundër vaksinimit për koronavirus. Ai ka dyshime te vaksinat e zhvilluara kundër Covid-19 dhe për këtë arsye askush nga familja e tij nuk është vaksinuar.

Interneti është burimi kryesor i informimit për Sllamnikun. Ky ligjërues i gjuhës gjermane në një shkollë private ka thënë se janë pikërisht rrjetet sociale ku është informuar më së shumti rreth vaksinimit. "Unë dhe familja ime jemi kundër vaksinimit, veçmas këtij vaksinimit me detyrim që po ndodh tani sepse, mbi të gjitha, nuk kemi një fazë përfundimtare", ka thënë Sllamniku.

Në Kosovë vaksinimi kundër Covid-19 është vullnetar por, sipas masave në fuqi kundër koronavirusit, qytetarët duhet të dëshmojnë që janë të vaksinuar ose që kanë rezultuar negativë në test për koronavirus nëse punojnë, hyjnë në restorante dhe bare (vende të mbyllura), ose gjatë udhëtimit.

Njëjtë si Sllamniku janë edhe disa qytetarë të tjerë të Kosovës me të cilët ka biseduar "Radio Evropa e Lirë" e që refuzojnë të vaksinohen dhe dyshojnë në ekzistencën e

koronavirusit.

Edhe Blerim Uruqi nga fshati Bresalc i Gjilanit dhe Gëzim Gashi nga Istogu ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se informacionet për Covid-19 i marrin kryesisht në "Facebook".

Që nga fillimi i pandemisë më shumë se 5 milionë persona e kanë humbur jetën nga Covid-19 në të gjithë botën. Në Kosovë, deri më 31 tetor, kanë vdekur 2 977 persona.

Mbi 1 milion përdorues të "Facebook"-ut në Kosovë

Në Kosovë janë mbi 1 milion përdorues të rrjeteve sociale, "Facebook"-ut dhe "Instagram"-it. Eksperti i rrjeteve sociale në Kosovë, Valon Kerolli, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se pikërisht "Facebook"-u është rrjeti social më i përdorur nga qytetarët për t'u informuar.

"Deri vitin e kaluar 'Facebook'-u i ka lejuar postimet kundër vaksinës. Tash 'Facebook'-u ka 'shpallur luftë' këtyre njerëzve dhe faqeve, por problemi kryesor te ne është për shkak të gjuhës shqipe. 'Facebook'-u funksionon me inteligjencë artificiale dhe gjuha shqipe është pak më e komplikuar dhe mund t'u ikë postimeve

kundër vaksinës", ka shpjeguar Kerolli.

Ai mendon se në Kosovë duhet të ekzistojnë fact-checkers (ata që i vërtetojnë informacionet) që në bashkëpunim me "Facebook"-un do të mund të luftonin lajmet e rreme në rrjetet sociale. "Kryesisht, luftën e bën vetë 'Facebook'-u sepse nuk është që ka bërë ndonjë kampanjë qeveria jonë kundër lajmeve të rreme. Pastaj është një problem tjetër që në Kosovë ka filluar të përdoret shumë rrjeti social 'Tik-Tok'. Nëse lexohen komentet, shumica e njerëzve që kanë vendosur të mos vaksinohen janë ndikuar nga 'Tik-Toku' dhe janë disa persona që bëjnë propagandë kundër vaksinës", ka thënë Kerolli. Në një raport të publikuar në qershor të këtij viti, "Facebook"-u ka bërë me dije se gjatë pandemisë ka fshirë 18 milionë postime kundër vaksinës. Në "Tik-Tok" zakonisht publikohen video-xhirimet.

Pse qytetarët u besojnë lajmeve të rreme?

Dren Gërguri, ligjërues në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", që nga fillimi i

pandemisë ka përcjellë përhapjen e informacioneve të rreme për Covid-19. Ai ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se mendimi kritik është me rëndësi të madhe kur flitet për informacione nga rrjetet sociale. Gërguri ka thënë se qytetarët duhet të përgatiten në kuptimin e njohurive rreth mediave dhe t'i identifikojnë burimet që janë kredibile.

Në mungesë të mendimit kritik, ai ka thënë se qytetari vjen në situatë kur dezinformatat bëhen pjesa kryesore në vendimmarrje për vaksinim apo jo. Sipas tij, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë është dashur të bëjnë fushatë më agresive kundër lajmeve të rreme. "Po të kishte fushatë të vazhdueshme të institucioneve në media, TV, por edhe në mediat online, kjo do të krijonte një narrativë që do të çonte drejt vaksinimit. Institucionet tona nuk e kanë bërë këtë lloj të fushatës, kështu që është krijuar një terren i përshtatshëm për të tjerët që të krijojnë narrativë kundër Covid-19 dhe kundër vaksinës", ka vlerësuar Gërguri.

Këto narrativa, sipas tij, nuk janë përballur me asnjë vështirësi që të shpërndahen në shoqërinë e Kosovës.

Krasniqi e njofton presidentin e NDI-së për rezultatin e PDK-së në zgjedhjet e 17 tetorit

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur në takim presidentin e Institutit Demokratik Amerikan (NDI), Derek Mitchell, i shoqëruar nga drejtori i NDI-së për Evropë, Robert Benjamin, drejtoresha e zyrës së këtij instituti në Kosovë, Nancy Soderberg dhe zyrtarët e lartë të

programeve të NDI-së në Kosovë, me të cilët ka diskutuar lidhur me procesin zgjedhor në Kosovë dhe zhvillimet aktuale. "Gjatë këtij takimi biseduam për sukseset e arritura nga kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës në zgjedhjet lokale. Tutje folëm për përgatitjet dhe mobilizimin që po e bëjmë për garën zgjedhore

në komunat ku kandidatët e PDK-së janë në balotazh. Përfaqësuesit e NDI-së i falënderova për ndihmën e vazhdueshme që ky institut ka dhënë dhe po vazhdon ta japë në Kosovë. Në veçanti, atyre u shpreha mirënjohje për bashkëpunimin e ngushtë me PDK-në", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".





KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE NË MAQEDONINË E VERIUT KA SHPALLUR REZULTATET PRELIMINARE TË RAUNDIT TË DYTË TË ZGJEDHJEVE LOKALE

VMRO-DPMNE dhe BDI-ja, fituese të zgjedhjeve lokale në Maqedoni

Edhe në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut ka dalë fituese partia opozitare maqedonase VMRO-DMNE. Sipas rezultateve preliminare të këtij raundi, kjo parti ka fituar 20 prej 44 komunave sa është votuar në balotazh. Te partitë shqiptare fitore ka shënuar Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), duke fituar shtatë komuna. Lëvizja Besa ka fituar në dy komuna, ndërsa Aleanca për Shqiptarët ka fituar në Gostivar

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) ka publikuar rezultatet preliminare të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut të cilat në taborin maqedonas nxjerrin fituese partinë opozitare maqedonase VMRO-DMNE, kurse te partitë shqiptare fituese është partia e Ali Ahmetit, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI). Sipas këtyre rezultateve, VMRO-DPMNE ka fituar 20 prej 44 komunave sa është votua në

balotazh, duke fituar të gjitha qytetet e mëdha si Manastirin, Ohrin, Gjevgjelinë, ndërsa në Shkup ka fituar kandidatja e pavarur, Danella Arsovska, që kishte mbështetjen e VMRO-DPMNE-së dhe të opozitës shqiptare.

LSDM-ja, sipas të dhënave të para të KShZ-së, ka fituar në shtatë komuna kryesisht të vogla. Në taborin e partive shqiptare fitues ka dalë Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) i Ali Ahmetit. BDI ka fituar shtatë komuna, përfshirë tri më të mëdhatë si Strugën, Kërçovën dhe Çairin.

Lëvizja Besa ka fituar në dy komuna, përfshirë edhe Tetovën, që është komuna më e madhe e banuar me shqiptarë, ndërsa Aleanca për Shqiptarët ka fituar në Gostivar.

KShZ-ja ka bërë me dije se raund të ri zgjedhjesh do të ketë për qytetin e Dibrës, ndërmjet kandidatit të BDI-së dhe atij të Aleancës për Shqiptarët.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e ka vlerësuar demokratik procesin zgjedhor në Maqedoninë e Veriut.

Kryetari i këtij komisioni, Aleksandar Dashtevski, ka thënë se në këto zgjedhje kanë dalë mbi 48 për qind e qytetarëve. "Vlerësoj se të dielën kishim proces zgjedhor demokratik, të qetë dhe disa probleme të vogla të izoluar që nuk ndikuan në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Pra, zgjedhjet konsideroj se ishin të suksesshme", ka deklaruar kryetari i KShZ-së, Aleksandar Dashtevski.

Në raundin e dytë u votua në 44

komuna nga gjithsej 80 sa ka Maqedonia e Veriut, si dhe për kryetarin e Shkupit, që është njësi e veçantë e pushtetit lokal. Sipas rezultateve, në dy raundet zgjedhore VMRO DPMNE-aj ka fituar 41 komuna nga 80 sa ka gjithsej Maqedonia e Veriut, dhe Shkupin si njësi e veçantë e pushtetit lokal. LSDM-ja ka fituar 16 komuna, BDI-ja dhjetë komuna, Lëvizja BESA dy komuna, Aleanca për Shqiptarët dy komuna, ndërsa partitë e tjera nga një komunë.

Kryeministri Zaev jep dorëheqje

Para publikimit të rezultateve të raundit të dytë, Zoran Zaev ka dhënë dorëheqje nga posti i kryeministrit të Maqedonisë së Veriut dhe drejtimi i partisë së tij, Lidhjes Social-Demokrate (LSDM). Në këtë mënyrë ai ka marrë gjithë përgjegjësinë për disfatën e partisë së tij në raundin e parë të zgjedhjeve lokale më 17 tetor dhe në balotazhin e mbajtur më 31

tetor.

Ai ka thënë se pavarësisht prej dorëheqjes, nuk është për zgjedhje të parakohshme, por që qeverinë ta drejtojë një kuadër tjetër i LSDM-së. "Unë marr përgjegjësinë për rezultatet e dobëta dhe paraqes dorëheqjen edhe nga posti i kryeministrit, sikur edhe nga posti i kryetarit të partisë. Nuk mendoj se duhet të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Do të qëndroj këtu gjatë kësaj periudhe për të organizuar një qeveri të re me një shumicë progresive që mund edhe të zgjerohet", ka deklaruar Zaev.

Kryetari i partisë opozitare VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski, ka deklaruar se opozita do të fitojë edhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. "Kemi vendosur bazat e një bashkëpunimi dhe një koalicion të mundshëm qeveritar. Ne dëshmuam se, edhe përkundër dallimeve, mund të bashkohemi rreth qëllimit të përbashkët, për një

Ali Ahmeti: BDI-ja, fituese e pakontestueshme e zgjedhjeve

Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se partia që drejton ka dalë fituese e zgjedhjeve lokale që janë mbajtur të dielën në Maqedoninë e Veriut. Me këtë rast, Ahmeti ka falënderuar votuesit për besimin e dhënë për BDI-në. “Edhe në këto zgjedhje vendore ju me vullnetin tuaj të shprehur lirshëm e bëtë BDI-në tuaj fitimtare dhe për këtë jam shumë mirënjohës dhe si gjithmonë ju premtoj se asnjëherë në jetë nuk do t’ju zhgënjëj dhe nuk do të turpëroj. Fitorja më e madhe është demokracia dhe liria, miq. Kjo më

gëzon shumë dhe jam shumë krenar që sot po shprehim bindjet tona nëpërmjet votës së lirë në të gjitha vendbanimet. Organizata juaj, Bashkimi Demokratik për Integrim, ngadhënjeu në shumicën absolute të komunave dhe me votat e grumbulluara është fituese e pakontestueshme e këtyre zgjedhjeve në komuna dhe në nivel republikan. Ju faleminderit për besimin e dhënë! Kjo është edhe një përgjegjësi shtesë të cilën me faqebardhësi do ta zbatojmë në përputhje me orientimet tona

programore”, ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në “Facebook”. Më tutje, ai ka thënë se Maqedonia e Veriut ka nevojë për stabilitet dhe reforma. “Vendi ynë ka nevojë për stabilitet, parashikueshmëri, reforma dhe zhvillim, përfshirë këtu edhe ballafaqimin me krizën shëndetësore dhe energjetike, por edhe kontestin me Bullgarinë që po bllokun rrugën tonë drejt Bashkimit Evropian. Ne jemi të përkushtuar për të ecur fuqishëm në rrugën progresive të zhvillimit, reformave dhe integritimit evropian”, ka shkruar Ahmeti.

Maqedoni pa korrupsion dhe e cila do të ecë përpara, për një Maqedoni të integruar në Bashkimin Evropian. Këtë mund ta bëjë një bllok i bashkuar opozitar që tashmë është realitet dhe që do të sjellë një fitore të

bindshme në zgjedhjet e parakohshme parlamentare”, ka deklaruar Mickovski. Ndërkohë, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka lavdëruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Sipas tij, zgjedhjet janë

zhvilluar sipas të gjitha standardeve demokratike. “Ishte një proces me rëndësi për të ardhmen e komunave. BDI-aj ka fituar Strugën, Kërçovën, Dollnenit, Çairit, Bogovinës, Tearcës dhe në Haraçinë”, ka

Hoxhaj: Dorëheqja e Zaevit, lajm i keq për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut

Ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës dhe deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj, e ka quajtur lajm të keq dorëheqjen e Zoran Zaevit nga pozita e kryeministrit të Maqedonisë së Veriut. Hoxhaj ka thënë se ky është një lajm i keq jo vetëm për Maqedoninë e Veriut, por edhe për shqiptarët që jetojnë atje. “Dorëheqja e Zoran Zaevit është lajm i keq për Maqedoninë e Veriut, për

shqiptarët atje, për Ballkanin, për zgjerimin e BE-së dhe për Perëndimin. Kam bashkëpunuar me qeveri të ndryshme të Maqedonisë së Veriut, por nga bashkëpunimi me të dua të ngreh lart arritjet e tij historike! Zoran Zaevi është viktimë e mosmbështetjes së BE-së sikurse edhe disa liderë të tjerë në Ballkan!”, ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



Kurti: Rruga jonë për liri na përkujton sakrificën e dëshmorëve

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me këshilltarin për çështje të kategorive të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Aziz Bici, kanë pritur të hënë në takim përfaqësuesit e familjeve të heronjve dhe dëshmorëve të

kombit, si dhe disa prej të plagosurve të periudhës së paraluftës së vitit 1998-99. Ata e kanë falënderuar kryeministrin për pritjen dhe e kanë njoftuar për punën dhe angazhimin e tyre të deritanishëm për kategorizimin e personave të plagosur gjatë demonstratave popullore.

Ndërsa Kurti ka shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për punën dhe kontributin e tyre të drejtë që kanë dhënë. “Rruga jonë për liri na përkujton sakrificën e dëshmorëve të secilit brez, e ne i kujtojmë ata me nder e plot krenari përherë”, ka thënë kryeministri Kurti.



Diskutohet për zbatimin e ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të hënën në takim anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të kryesuar nga deputeti Driton Selmanaj.

Ky komision parlamentar që me fillim të muajit tetor ka marrë vendim për formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore. Ministria Haxhiu fillimisht e ka vlerësuar angazhimin e komisionit, njëherësh i ka njoftuar deputetët lidhur me dy ligjet përkatëse. Haxhiu ka njoftuar anëtarët e komisionit për çështjet të cilat janë duke u

adresuar me ndryshimet ligjore lidhur me Ligjin për KPK të cilat afektojnë gjithashtu në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pastaj për vështirësitë dhe mangësitë e identifikuar në zbatim të Ligjit për Procedurën Përmbartimore si dhe çështjet e adresuara me ndryshimplotësimet e reja të këtij ligji, përfshirë analizën e cila është duke u kryer si dhe procesin e ndryshimplotësimit të udhëzimit administrative për tarifën e përmbartësve privat.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Driton Selmanaj, pasi ka shprehur disa nga problemet dhe vështirësitë për zbatimin e këtyre ligjeve, ka theksuar gatishmërinë e tij dhe të anëtarëve të këtij komisioni për të bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë për adresimin e çështjeve që kanë të



bëjnë me ligjet e lartpërmendura dhe ka njoftuar ministren Haxhiu për hapat më tutje dhe komunikimin për çështjet e rëndësishme të zbatueshmërisë së këtyre ligjeve.

Ministria Haxhiu ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me qëllim të avancimit të mëtejme të legjislacionit në fuqi dhe ndryshimeve të nevojshme që duhen bërë, veçanërisht pas

monitorimit dhe rekomandimeve të dala nga Komisioni për Legjislacion në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe adresimin e rekomandimeve të tilla.

Dështon përzgjedhja e anëtarit të bordit të ankesave të KPM-së

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Të hënën në Kuvendin e Kosovës është mbajtur intervistimi i kandidatëve për anëtarë të Bordit të Ankesave të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Fillimisht ishin katër kandidatë, përkatësisht: Teki Shehu, Sedat Lekiqi, Shefki

Berisha dhe Ivica Ivanović. Shehu dhe Lekiqi u tërhoqën para fillimit të intervistave, prandaj u intervistuan vetëm Berisha dhe Ivanović. Procesi është anuluar për shkak se asnjëri kandidat nuk mori pikët e duhura për t'u propozuar për votim në seancë plenare.

Flutura Kusari, juriste e së drejtës së medias, ka thënë se është

fatkeqësi që konkursi për anëtar të bordit nuk ka tërhequr më shumë kandidatë. "Është bord me rëndësi të jashtëzakonshme dhe nëse procesi anulohet, shpresoj që do të ketë më shumë të interesuar. Jo shpresoj, por aman aplikoni", ka thënë Kusari përmes një postimi në llogarinë e saj në "Facebook".

Ajo ka thënë se atmosfera në

Komisionin Ad-Hoc ishte shumë e mirë, pozitive dhe dominonte fryma bashkëpunuese në mes të të gjithë deputetëve të të gjitha partive politike. "Vlerësimi u bë në mënyrë të hapur nga të gjithë deputetët, vlerësimi ishte i shoqëruar me arsytime bindëse dhe poentimi ishte gati njësoj nga secili deputet, që tregon se vlerësimi ishte korrekt. Herën

tjetër Komisioni Ad-Hoc duhet të njoftojë mbajtjen e intervistave në kalendarin online të Kuvendit", ka theksuar ajo.

Komisioni Ad-Hoc ka këtë përbërje: Fitim Uka, Doarsa Kica-Xhelili, Mergim Lushtaku, Fitim Haziri, Erxhan Galushi, Nijazi Isaku, Arbresha Kryeziu-Hyseni, Agim Veliu dhe Blerita Deliu-Kodra.

Në periudhën janar - tetor u kryen 342 operacione në Klinikën e Neurokirurgjisë

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka njoftuar se, sipas raportit të punës për periudhën janar - tetor 2021, në Klinikën e Neurokirurgjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës

janë kryer 342 operacione. Në mesin e tyre, 97 raste ishin me tumor në tru, të cilat i kanë operuar me sukses mjekët neurokirurgë, bashkë me anesteziologë dhe stafin përcjellës.

Brenda kësaj kohe në sallat e

Neurokirurgjisë, gjithashtu, janë bërë 146 operacione të Hernisë Diskale. Për këta dhjetë muaj, po ashtu, 99 pacientë, të cilët kishin gjakderdhje në tru, i janë nënshtruar operimit në Klinikën e Neurokirurgjisë.





ZPS-ja urdhërohet që deri më 17 dhjetor ta dorëzojë dosjen paraprake në rastin e ish-krerëve të UÇK-së

HAGË, 1 NËNTOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) është urdhëruar që deri më 17 dhjetor të këtij viti ta dorëzojë dosjen paraprake në rastin ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u akuzuar për krime lufte nga Gjykata Speciale. Vendimi i gjyqtarit paraprak, Nicolas Guillou, është marrë pasi në konferencën e tetë mbi ecurinë e çështjes, të mbajtur më 29 tetor, prokuroria kishte deklaruar se pasi kanë shqyrtuar burimet që kanë, konfirmojnë se do të jenë në gjendje ta

dorëzojnë dosjen paraprake në rastin e Hashim Thaçit e të tjerëve dhe materialet që lidhen me të më 17 dhjetor 2021. Lidhur me këtë deklaram, mbrojtja e të akuzuarve kishte shfaqur pakënaqësitë e tyre, raporton "Betimi për drejtësi". Më 9 nëntor të vitit të kaluar, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Kadri Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor të vitit 2020.

Mbi 400 raste aktive me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Të hënën në Kosovë janë regjistruar edhe pesë raste të reja me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se kjo shifër ka dalë pas testimit të 1 115 mostrave. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimitë. Që nga muaji mars i vitit 2020 nga sëmundja Covid-19 kanë vdekur 2 977 persona. Shifra bazohet në të dhënat zyrtare. Nga sëmundja janë shëruar edhe 14 pacientë, ndërsa raste aktive janë 430. Vaksinimi kundër koronavirusit në Kosovë ka filluar në mars të këtij viti. Gjithsej janë administruar mbi 1.5 milion vaksina. Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka njoftuar të hënën se 67 pacientë me Covid-19 janë të shtrirë në klinika dhe spitale, prej të cilëve 33 po trajtohen me oksigjenoterapi, ndërsa tre pacientë janë në kujdes intensiv. Ministria e Shëndetësisë ka rikujtuar se plani pesëjavësh për vaksinim gjatë fundjavës ka përfunduar. "Rrjedhimisht, tash qendrat e vaksinimit punojnë vetëm gjatë ditëve të punës. Vaksinimi i një numri të konsiderueshëm të qytetarëve




me dozën e parë dhe të dytë të vaksinës kundër Covid-19 dhe situata epidemiologjike më e qetë ka ndikuar që edhe kërkesat për vaksinim gjatë muajit tetor të jenë më të vogla. Ekipet e vaksinimit ia kanë dalë t'i përgjigjen çdo kërkesë për vaksinim, gjatë pesë ditëve të punës, pa pasur nevojë të punohet fundjavës", ka njoftuar

MSh-ja. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se numri i vaksinave kundër Covid-19, ashtu edhe kundër gripit sezonal, është i mjaftueshëm, prandaj i ka inkurajuar qytetarët të cilët duhet të vaksinohen, që t'i shfrytëzojnë oraret e përcaktuara gjatë pesë ditëve të punës brenda javës.

PZAP-i merr vendim për ankesën e Bekim Jasharit, s'ka rinumërim të vendvotimeve

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) ka refuzuar ankesat e kandidatit për kryetar të komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, për pretendimet e parregullsisë gjatë procesit zgjedhor më 17 tetor. Kryetari aktual që synonte edhe një mandat qeverisës në Skenderaj bëri ankesë në PZAP duke kërkuar që të hapen kutitë e votimit dhe të rinumërohen votat në disa vendvotime, por PZAP-i ka refuzuar këtë kërkesë

të Jasharit. Në vendim të PZAP-së thuhet se: "Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit A.nr. 724/2021 e datës 29.10.2021, e parashtruar nga Lista e Pavarur - Bekim Jashari me seli në Skenderaj, me të cilën ka kërkuar që të hapen kutitë e votimit dhe të rinumërohen vendvotimet 2122b/01D dhe 2101 X/01R, si shkak i parregullsisë gjatë procesit të votimit për zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 17.10.2021".



Të hënën e ardhshme mblidhet Kuvendi

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës të hënën ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka diskutuar lidhur me agjendën e punës së Kuvendit.

Anëtarët e kryesisë dhe kryetarë të grupeve parlamentare u pajtuan që për shkak të punimeve të Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE-Kosovë,

të cilat do të zhvillohen më 3, 4 dhe 5 nëntor në Kuvendin e Kosovës, kryesia të mblidhet sërish të hënën e ardhshme, për ta caktuar seancën plenare të radhës.



Kurti pret në takim përfaqësuesit e NDI-së: Ekonomia jonë do të rritet për 9.9 për qind

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI), kryesuar nga presidenti Derek Mitchell. Thellimi i bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet Qeverisë dhe NDI-së ishte tema kryesore e këtij takimi. “Qeveria e re, jo vetëm për nga koha e marrjes së detyrës, por edhe për nga stili i udhëheqjes, është qeveria e ndryshimeve dhe mundësive të mëdha për njerëzit”, ka deklaruar kryeministri Kurti. Ai ka bërë me dije rezultatet dhe pritjet për zhvillim ekonomik. Në bazë të projeksioneve dhe statistikave të deritanishme, deri në fund të këtij viti Kosova do të ketë një rritje mbresëlënëse dyshifrore. Kurti ka theksuar se, sipas vlerësimit të Bankës Qendrore të

Kosovës, ekonomia jonë do të rritet për 9.9 për qind. Ndërsa krahasuar me vitin paraprak, ai ka thënë se të hyrat tatimore për periudhën janar-shtator janë rritur për 33 për qind dhe eksportet për 68 për qind. Ai ka theksuar se bazuar në këtë performancë të shkëlqyer ekonomike, projektbuxheti i vitit 2022 është më i larti dhe më gjithëpërfshirësi ndonjëherë, në vlerë 2.75 miliardë euro. Kryeministri Kurti vuri theksin te përkushtimi për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe forcimin e luftës kundër kontrabandës, evazionit fiskal e kriminalitetit në gjithë territorin e Republikës, duke përmendur rezultatet konkrete në këta shtatë muaj.

Lidhur me gjendjen aktuale me pandeminë, kryeministri Kurti i njoftoi që, përkundër asaj që kur qeveria ka pranuar detyrën nuk ka pasur vaksina të blera e as të kontraktuara, brenda shtatë muajsh janë administruar rreth 1.6



milion doza.

Kurti ka thënë se deri më tani janë rreth 63 për qind të qytetarëve mbi 16 vjeç të vaksinuar me të paktën një dozë, ndërsa mbi 54 për qind kanë marrë dy dozat e vaksinës, gjë

që e bën Kosovën të prijë në rajon. Në këtë takim u bisedua për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në politikëbërje dhe vendimmarrje si dhe në afrimin e institucioneve me qytetarët.

Temë e takimit ishin edhe zgjedhjet lokale të mbajtura si dhe balotazhi që po afrohet. Zgjedhjet e lira dhe demokratike të 17 tetorit u vlerësuan për mbarëvajtjen e tyre.

Odat ekonomike kërkojnë ndryshime në Projektligjin për Tregti me Jashtë



PRISHTINË, 1 NËNTOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka mbajtur dëgjim publik lidhur me Projektligjin për Tregti me Jashtë, ku është kërkuar që Ligji për Masat e Mbrojtjes në Importe të inkorporohet në këtë projektligj si dhe të saktësohet neni 23 në mënyrë që të evitohen dykuptimësitë. Koordinatorja e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Qëndresa Ibrahim, ka thënë se me Ligjin për Tregti me Jashtë duhet të përcaktohen masat kundër importit të subvencionuar dhe se në kuadër të këtij ligji duhet të inkorporohet edhe Ligji për

Masat e Mbrojtjes në Importe. Derisa argumentoi arsyet pse duhet të ndodhë kjo. “OAK-u rekomandon që Ligji për Masat e Mbrojtjes në Importe të inkorporohet komplet në Projektligjin për Tregti me Jashtë ashtu siç e kanë të rregulluar edhe vendet e rajonit. Arsyetimi është se ky ligj do të shqyrtohet edhe nga investitorë të huaj, të cilët nuk kanë njohuri për komplet legjislacionin e vendit, andaj është shumë e nevojshme të ketë përmbledhje të të gjitha çështjeve që rregullojnë importin, eksportin dhe kalimin transit të mallrave nëpërmjet Republikës së Kosovës në një ligj të vetëm”, ka thënë ajo. Lidhur

me këtë, Zef Deaj nga MINT ka thënë se ligji parasheh edhe masën mbrojtëse në importe, por edhe atë për importin e subvencionuar. “Neni 32 i këtij ligji parasheh masat mbrojtëse në importe, ku njëkohësisht ne e kemi edhe ligjin e ndarë për masat mbrojtëse në importe, i cili është aplikuar dhe vazhdon të aplikohet”, ka thënë ai. Andrra Nurkollari nga Oda Ekonomike Amerikane tha se e kundërshtojnë nenin 23 të Projektligjit ngaqë vlerësojnë se i njëjti është në kundërshtim me parimet e ekonomisë së tregut, pasi pengon qarkullimin e lirë të mallrave. “Pas një analize të Projektligjit, oda ka kundërshtim

me marrjen e lejes së importit dhe eksportit, pasi konsiderojmë se pengon qarkullimin e mallrave”, u shpreh ajo. Edhe Emrush Ujkani nga Këshilli i Investitorëve Evropianë ka thënë se disa ndryshime duhet të bëhen te neni 23. “Ajo që na gëzon janë tri aspekte. Ky ligj është në tërësinë e vet i harmonizuar me Organizatën Botërore Tregtare, e mbron tregun dhe parimet janë të inkorporuara në Ligjin dhe nga perspektiva. Këto janë të arritura. Ato që i kemi si komente do t'i ndajmë me administratën e Kuvendit, është fjala për nenin 23”, ka thënë

Ujkani. Lumnije Hashani nga Oda Ekonomike e Kosovës ka thënë se ky projektligj është në përputhje me MSA-në dhe tregtinë e jashtme. “Ne si komitet i biznesit kërkojmë që ky ligj të miratohet sepse i ndihmon bizneset për të bërë biznes”, ka thënë ajo. Përkrahje për këtë Projektligj dha edhe Oda Ekonomike Gjermane e Kosovës. Ndërkaq, deputeti Pal Lekaj ka thënë se nga praktikat e mëparshme është vërejtur se ka keqpërdorime prandaj, siç ka thënë ai, neni 23 duhet të saktësohet në mënyrë që të evitohen dykuptimësitë. (Kp)



“Trump-i francez”, kush është Eric Zemmour, rivali më serioz i Emmanuel Macron në zgjedhjet presidenciale

Nga **Benedikt BERNER**
“Project Syndicate”

Sipas një sondazhi të ri që tronditi Francën kohët e fundit, Eric Zemmour, eseisti i ekstremit të djathtë dhe një moderator i njohur televiziv, do të merrte 17 për qind të votave, nëse do të garojë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale. Kjo e pozicionon atë në vendin e dytë, përpara Marine Le Pen të Tubimit Kombëtar të ekstremit të djathtë.

I njohur që nga fillimi i viteve 2000 për paraqitjet e tij të njohura televizive, dhe për rubrikën e tij të rregullt në gazetën konservatore “Le Figaro”, Zemmour është shndërruar aktualisht në një lojtar të rëndësishëm në një lojë politike, të cilin ai shpreson që ta destabilizojë – megjithëse ai mbetet i paqartë nëse do të garojë apo jo në presidencialet e prillit të vitit të ardhshëm.

Megafoni i tij politik është “CNews”, një kanal televiziv me ndikim i mbështetur nga miliardi Vincent Bolloré, pronar i konsorciumit “Vivendi”. Edhe pse programet e tij me popullorë nuk tërheqin zakonisht më shumë se 800.000 shikues, “CNews” e ka dyfishuar audiencën e tij gjatë 4 viteve të fundit, duke e vendosur atë në vendin e dytë midis 4 televizioneve më të rëndësishme të lajmeve në Francë.

Modeli i biznesit i kompanisë, kombinon mbulimin e lajmeve në kohë reale, me komente dhe debate që tentojnë të thjeshtëzojnë çështje komplekse, duke shfaqur shpesh pozicione ekstreme.

Çelësi i suksesit të fundit të “CNews” dhe Eric Zemmour, është se ata kanë përvetësuar një leksion nga Donald Trump: jii ekstremist dhe provokues.

Për shembull, shpërthimi i fundit i Zemmour, ishte thirrja për ndalimin e emrave “të huaj” si për shembull Mohammed. Ndërsa e djathta ekstreme franceze ka qenë tejet e fiksuar gjatë 30 viteve të fundit me Islamin, emigracionin, dështimet në arsim, dhe rënien e pretenduar të qytetërimit francez, retorika ekstremiste e Zemmour i ka nxjerrë në plan të parë këto çështje.

Dhe termi “ekstremist” nuk është aspak një ekzagjerim. Zemmour është dënuar dy herë vitet e fundit për përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjen e dhunës racore. Ai e vë theksin tek të njëjtat tema të nxehta në librin e tij të ri “La France n’a pas dit son dernier mot (Franca nuk e ka thënë ende fjalën e saj të fundit).

Duke ngatërruar Islamin me Islamizmin, ai shpreson që ta stigmatizojë të gjithë këtë besim fetar, duke nxitur kundërshtimin ndaj emigracionit. Ai pretendon se emigrantët myslimanë do të dominojnë banorët vendas të Evropës, dhe se “islamizimi i rrugëve të qytetit” nga “kolonizatorët” e rinj, kërcënon mbijetesën e kombit francez.

“Asnjë qytet i vogël, asnjë fshat në Francë nuk është i sigurt nga grupimet e egra të çëqenëve, kosovarëve, magrebianëve apo bandave afrikane që vjedhin, përdhunojnë, plaçkitin, torturojnë dhe vrasin”-shkruan ai. Nuk është për t’u habitur pse Zemmour e shtrembëron haptazi historinë.

Ai pretendon se regjimi i Vishisë që bashkëpunoi me nazistët, “i mbrojti hebrenjtë francezë” gjatë Luftës së Dytë Botërore. Mizogjia dhe homofobia e tij agresive, janë po aq të ashpra. Zemmour dëshiron që këto tema të jenë në qendër të debatit në zgjedhjet presidenciale pranverën e ardhshme.

Rregullatori francez i transmetimeve televizive, Këshilli i Lartë i Transmetimeve Audiovizive (CSA), ka vendosur që ta trajtojë tashmë atë si një kandidat, duke monitoruar kohën e tij televizive, në mënyrë që të mos pretendojë më shumë se kandidatët e tjerë.

Fenomeni “Zemmour”, po shqetëson jo pak partitë politike franceze në të gjithë spektrin politik, por jo për të njëjtat arsye. Më e shqetësuar është sigurisht Marine Le Pen, pasi ajo shpreson të jetë kandidatja që do të përfaqësojë të djathtën ekstreme.

Tradicionalisht, vota e protestës në Francë, është ndarë mes populistëve dhe abstenuesve dhe të paktën deri në zgjedhjet e 2017-ës, dhe kjo tendencë e favorizoi në përgjithësi partinë e saj. Për ta paraqitur veten si një kandidat legjitimë presidenciale në vitin 2017, Le Pen e moderoi mesazhin e partisë, dhe u distanca nga babai i saj (themeluesi dhe ish-udhëheqësi i partisë), si dhe nga retorika e tij reaksionare, raciste dhe anti-semite.

Një vit më pas, ajo ndryshoi edhe emrin e partisë. Por moderimi nuk është pritur mirë nga pjesa më e madhe e bazës së saj të mbështetësve, një pjesë e konsiderueshme e së cilës ka kaluar me Zemmour. Një

sondazh i bërë publik më 28 shtator, tregoi se mbështetja për Le Pen ishte rreth 16 për qind, nga 28 për qind në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2017.

Ngritja e Zemmour po shihet po ashtu me shqetësim nga partia tradicionale e qendrës së djathtë, Les Républicains (Republikanët). Ndërsa shumë konservatorë francezë do ta kishin bezdi të votonin për Tubimin Kombëtar për shkak të së kaluarës së tij anti-semite, ata mund të shohin tek Zemmour, një hebre sefardik, një zëdhënës të pranueshëm të pozicionit të së djathtës bashkëkohore mbi emigracionin.

Por Zemmour është paraqitur gjithashtu edhe si një kampion i Golizmit, duke trajtuar 3 nga temat e preferuara të Charles de Gaulle: pavarësinë kombëtare, politikën sociale dhe idenë e Francës së krishterë. Duke luajtur në kufijtë fluidë midis të djathtës dhe të djathtës ekstreme, ai po merr vota nga Republikanët, gjë që Le Pen as që mund ta kishte shpresuar ndonjëherë.

Por ndërsa një kandidim i Zemmour mund ta dëmtojë të djathtën, ai edhe mund t’i shërbejë asaj. Nëse Zemmour e zvogëlon peshën e Le Pen në zgjedhjet e afërta, një tjetër kandidat i kraut të djathtë, si Xavier Bertrand, favorit në sondazhe, mund të mbizotërojë si sfidues i presidentit aktual Emmanuel Macron në raundin e dytë të zgjedhjeve.

Macron do të kishte shumë më tepër arsye të ishte i shqetësuar në një balotazh kundër Bertrand, një kandidat që mund të kërkojë një mbështetje të

gjerë, përfshirë votuesit e majtë dhe centristë, të cilët duan të parandalojnë me çdo kusht një mandat të dytë të Macron.

Po ashtu Macron mund të dëmtohet jo pak edhe efekti negativ, që do të kenë në debatin e përgjithshëm temat e ekstremit të djathtë. Ai do të dëshirojë të nxjerrë në pah arritjet e tij ekonomike dhe sociale, reformat e tij në sistemit arsimor dhe bindjet e tij pro-evropiane. Por kjo nuk do të jetë e lehtë, kur bën fushatë kundër një kundërshtari, që mban në gojë vetëm çështjen e “Islamit” dhe “emigrimin”.

Mbetet për t’u parë nëse Zemmour do të kandidojë apo jo. Disa analistë dyshojnë nëse ai mund të ketë mbështetjen e nevojshme të të paktën 500 kryebashkiakëve. Por 17 për qind e votuesve francezë që mbështesin kandidaturën e tij, këto çështje nuk mund të injorohen.

Një pjesë e konsiderueshme e publikut, është qartazi e zhgënjyer nga figurat që ka prodhuar vitet e fundit elita politike franceze. Çfarëdo që të vendosë të bëjë Zemmour, ai bashkë me “CNews” dhe media të tjera të kraut të djathtë, e kanë ndryshuar debatin, duke detyruar të gjithë kandidatët që të fokusohen tek emigracioni dhe kriminaliteti në vend.

Edhe Macron është detyruar që t’i përshtatet rrethanave, dhe kjo shihet për shembull në vendimin e tij për të vendosur kufizime të rrepta mbi autorizimet e vizave për shtetasit marokenë, algerianë dhe ata tunizianë. Pa u bërë ende kandidat, Zemmour është tashmë një forcë me ndikim në zgjedhjet e vitit të ardhshëm.

Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

KOK-u dërgon në KON ankesën për refuzimin që Serbia i bëri delegacionit të boksit

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës ka deponuar ankesën në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (KON/IOC) në lidhje me refuzimin që iu bë delegacionit të boksit të Kosovës, të cilit tri herë iu refuzua hyrja për në shtetin e Serbisë, ku do të duhej të merrte pjesë në Kampionatin Botëror të Boksit që po mbahet në Beograd. Ekipi i boksit u ndalua në kufi nga policia serbe, e cila me urdhër të Qeverisë së Serbisë nuk lejoi ekipin tonë të kalonte kufirin të "Dheu i Bardhë" një herë dhe Merdar dy herë, më 23 dhe 24 tetor të muajit të kaluar.

KOK-u ka deponuar gjithë materialin me dëshmitë e refuzimit të hyrjes të ekipit të

boksit në kufi, duke iu bashkëngjitur foto, video, shkrime të mediave ndërkombëtare, letrat dërguar Federatës Botërore të Boksit Amator (AIBA) nga KOK-u dhe Federata e Boksit e Kosovës etj. Në e letrën e dërguar nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, për presidentin e KON-it, Thomas Bach, krahas përshkrimit të të gjithë ngjarjes në mënyrë kronologjike, është kërkuar nga shtëpia e Lëvizjes Olimpikë në botë, të marrë të gjitha veprimet e duhura ndaj organizatorëve të botërorit të boksit dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në moslejimin e hyrjes së ekipit të boksit të Kosovës në Serbi. "Në rast se këto veprime



shpëtojnë pa ndonjë dënim të vërtetë, mesazhi i gjithë komunitetit sportiv do të jetë se sporti mund të përdoret si platformë e veprimeve politike dhe dëmtoese. Ekipi i Kosovës është dëmtuar në të gjitha aspektet e mundshme:

moralisht, fizikisht, psikologjikisht dhe financiarisht. Ne jemi bërë edhe një herë dëm kolateral i marrëdhënies të paqarta dhe ne nuk jemi gati të vazhdojmë duke vuajtur nga regjimet politike të një vendi tjetër. Kjo është një mundësi e

mirë për familjen olimpikë, në mënyrë që të sjellim vendime të përshtatshme dhe të drejta, dhe t'i tregojmë botës se jemi gati t'i mbrojmë vlerat tona dhe për këtë nevojiten të përfshihen të gjitha palët e interesit në sport", thuhet në letrën e presidentit Krasniqi. Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, janë në kontakt të vazhdueshëm me drejtuesit e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, me të cilët kanë diskutuar gjerë e gjerë për çështjen e boksit gjatë takimeve në Kretë të Greqisë, ku javën e kaluar u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Asociacionit Ndërkombëtar të Komiteteve Olimpikë (ANOC).

Unitedi në Itali për ta treguar forcën

BERGAMO, 1 NËNTOR - Manchester Unitedi synon t'i regjistrojë tri fitore radhazi në Ligën e Kampionëve në përballjen që e zhvillon sonte (e martë) kundër Atalantës në Ligën e Kampionëve. "Djajtë e kuq" aktualisht janë në krye të Grupit F, duke mbledhur gjashtë pikë nga tri ndeshjet e tyre të para, ndërsa Atalanta është e treta në grup me vetëm dy pikë prapa kundërshtarëve të sotshëm në Bergamo.

Atalanta do të jetë në këtë ndeshje pa shërbimet e Berat Gjimshetit, Robin Gosens, Rafael Toloi, Matteo Pessina dhe Hans Hateboer, kurse Manchester Unitedi është i kompletuar për këtë ndeshje. Trajneri Gian Piero Gasperini nuk e fshehu rëndësinë e përballjes me skuadrën angleze.



"Për ne është një ndeshje shumë e rëndësishme, ku vlen vetëm fitorja. Me rezultate të tjera, gjërat nuk do të ndryshonin shumë. Ne e dimë që na nevojiten edhe gjashtë pikë për ta kaluar fazën e

grupeve. Prandaj të martën do të jetë ndeshje shumë e rëndësishme, por jo vendimtare", ka thënë Gasperini. Ndeshje interesante do të zhvillohen edhe në Grupin E. Bayern Muncheni që është

GRUPI E		GRUPI G	
21:00 Bayern Munchen - Benfica 21:00 Dynamo Kyiv - Barcelona		18:45 Wolfsburg - Salzburg 21:00 Sevilla - Lille	
Tabela		Tabela	
1. Bayern Munchen	9 pikë	1. Salzburg	7 pikë
2. Benfica	4	2. Sevilla	3
3. Barcelona	3	3. Lille	2
4. Dynamo Kyiv	1	4. Wolfsburg	2
GRUPI F		GRUPI H	
21:00 Atalanta - Manchester United 21:00 Villarreal - Young Boys		18:45 Malmo - Chelsea 21:00 Juventus - Zenit St. Petersburg	
Tabela		Tabela	
1. Manchester United	6 pikë	1. Juventus	9 pikë
2. Villarreal	4	2. Chelsea	6
3. Atalanta	4	3. Zenit	3
4. Young Boys	3	4. Malmo	0

lider i grupit, e pret Benficën, kurse Barcelona i shkon Dynamo Kyivit me synim për t'i

marrë tri pikët e me shpresë që Benfica mposhtet në Gjermani dhe rrëmben pozitën e dytë.

Erjon Kastrati, MVP i xhiros së dytë në Ligën Unike

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Xhiroja e dytë në Ligën Unike ka dhuruar ndeshje interesante në fundjavë. Derbi u zhvillua ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Pejës, që përfundoi 93-92, pas dy vazhdimeve. Basketbollisti më i mirë në parket ishte Erjon Kastrati i Yllit me 31 pikë, pesë kërcime, gjashtë asistime dhe tre topa të vjedhur, duke e pasur indeksin e ndeshjes 30. Kastrati është ndër lojtarët më të dalluar në skuadrën therandase, që është kampion i Kosovës, Ligës Unike dhe fitues i Superkupës

Mbarëkombëtare. Teuta e Durrësit mundi Rahovecin 103-123, ku u dallua Cameron Satterwhite me 30 pikë, 9 kërcime, tri asistime dhe tre topa të vjedhur, duke pasur indeksin e ndeshjes 40, një shifër rekord për këtë edicion në Ligën Unike. Te skuadra durrsake u dallua edhe Tyler Peterson me 25 pikë, shtatë kërcime, gjashtë asistime dhe një bllokadë. Courtney Fells ishte edhe një herë i jashtëzakonshëm për Prizrenin 16, në fitoren ndaj Tiranës, duke kontribuar me 31 pikë, 11

kërcime, pesë asistime dhe topa të vjedhur, kurse indeksin e kishte 36. Kamza Basket shënoi fitoren e dytë në këtë edicion, duke mundur Vllazninë e Shkodrës 82-72, ku u dallua Matthew Eldbrigde me 15 pikë, 10 kërcime, dy asistime, dy topa të vjedhur dhe tri bllokada. Top 5-shja: Erjon Kastrati i Golden Eagle Yllit, Cameron Satterwhite i Teutës, Courtney Fells i Prizrenit 16, Matthew Eldbrigde i Kamza Basket dhe Tyler Peterson i Teutës.



Messi: Dua të kthehem në Barcelonë si sekretar teknik

PARIS, 1 NËNTOR - Ylli argjentinas i PSG-së, Lionel Messi, ka thënë se dëshiron ta marrë postin e sekretarit teknik kur të pensionohet nga futbollit dhe shpreson se ky post do t'i mundësohet në Barcelonë. Messi i kaloi 21 vjet në klubin katalonas, kur u bë

një prej futbollistëve më të mirë, nëse jo më i miri në historinë e këtij sporti. Messi u detyrua të largohet nga klubi në verë sepse Barça nuk ishte në gjendje t'i mundësohet atij kontratë të re për shkak të telasheve financiare. I pyetur në një intervistë nga "Sport"

nëse dëshiron të kthehet në Barcelonë një ditë, Messi është përgjigjur: "Po. Gjithmonë kam thënë se do të doja ta ndihmoja klubin". "Do të doja të bëhem sekretar teknik dikur, nuk e di nëse do të jetë në Barcelonë apo jo apo nëse do të jetë diku tjetër. Nëse ka

mundësi, do të doja ta ndihmoj klubin përsëri me çfarëdo që mundem, sepse ky është klubi që e dua dhe dua që klubi të vazhdojë të jetë mirë dhe të vazhdojë të rritet për të qenë një prej më të mirëve në botë", ka deklaruar 34-vjeçari argjentinas.



Ylli dhe Prizreni 16 fitojnë në Ligën Unike

SUHAREKË, 1 NËNTOR - Golden Eagle Ylli ka mundur Pejën me rezultat 93-92 (15-20, 19-11, 22-19, 15-21, 22-21), në xhiron e dytë të Ligës Unike, një përballje që u vendos pas dy vazhdimëve. Fillimi i ndeshjes ishte interesant, me pejanët që kishin epërsi të lehtë në çerekun e parë, që e përmbyllën me shifrat 15-20. Në periudhën e dytë u shënuan shumë pak pikë nga të dyja skuadrat. Therandasit këtë herë ishin më të mirë, ndërsa rezultati i pjesës së parë ishte 34-31. Kampionët e Ligës Unike vazhduan me lojë të mirë në periodën e tretë, ku kishin epërsi deri në dhjetë pikë, 49-39, megjithatë mysafirët u rikthyen shpejt për t'i afruar shifrat në 51-50, por pesë pikë nga vendasit bënë që rezultati në semafor pas 30 minutash të jetë 56-50. Çereku i fundit ishte shumë interesant, ku u karakterizua me barazim të shpeshtë të rezultatit dhe herë njëra skuadër dhe herë tjetra kalonte në epërsi. Tre minuta nga fundi, Ylli po fitonte 68-65, por Peja nuk u dorëzua dhe kaloi në epërsi 68-61, megjithatë një treshe nga Gëzim Morina në sekondat e fundit bëri që ndeshja të shkonte në vazhdimë. Përballja interesante vazhdoi edhe në vazhdimë me vendasit që shënuan gjashtë pikë radhazi për 82-78, por Sirko me tri pikë ngushtoi shifrat në 82-81, më pas Randolph shënoi dy pikë nga gjuajtjet e lira dhe në sekondat e fundit Sami Hajzeri



shënoi për 84-4, dhe ndeshja shkoi sërish në vazhdimë. Dueli i barabartë vazhdoi edhe në këtë pjesë. Në fund të kësaj pjesë Ylli po fitonte 93-92 dhe gjuajtja e Sirkos nuk ishte e saktë. Pas 50 minutave lojë Golden Eagle Ylli triumfoi 93-92, që ishte e dyta këtë edicion, kurse pejanët kanë një fitore dhe një humbje. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Erjon Kastrati me 31 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime dhe Brandon Radolph me 19 pikë, nëntë kërcime e gjashtë asistime, kurse te Peja u dalluan Henrik Sirko me 23 pikë e nëntë kërcime, Stephen Maxwell me 20 pikë e 11 kërcime dhe Ilter Erdem me 29 pikë. Prizreni 16 ka shënuar fitore në udhëtim ndaj Tirana Neptun 81-93 (19-20, 21-27, 23-17, 18-29), në xhiron e dytë të Ligës Unike. Mysafirët e nisën ndeshjen mirë me një epërsi 0:7 dhe më pas kishin epërsi të lehtë në

çerekun e parë, që u ngushtua në fund minimalisht 19-20. Prizrenasit ishin më të mirë në periudhën e dytë, duke pasur epërsi konstante, ku më e larta ishte shtatë pikë, aq sa përfundoi pjesa e parë 40-47. Vendasit u përgjigjën në periudhën e tretë, ku barazuan shifrat në 49-49, më pas zhvillohet lojë tërësisht e barabartë, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63-64. Në 10 minutat e fundit prizrenasit treguan fuqinë dhe ishin më të vëmendshëm, sidomos në çastet vendimtare, duke triumfuar me rezultat 81-93. Te Tirana Neptun u dalluan Julian Hamati me 19 pikë e 13 kërcime dhe Endrit Hysenagolli me 18 pikë e 17 kërcime, kurse te Prizreni 16 më i miri në parket ishte Courtney Fells me 31 pikë e 11 kërcime. Të dyja skuadrat kanë nga një fitore dhe një humbje.

Utah Jazz, 'leksion' kampionëve të Milwaukeees

MILWAUKEE, 1 NËNTOR - Utah Jazz triumfoi 107-95 në fushën e ekipit kampion të Milwaukeees, një përballje mes dy prej skuadrave më të mira në NBA. Ndeshje e dominuar nga Jazzi, që ngjitet në krye të renditjes në Perëndim. Mitchell me 28 pikë ishte më i miri për miqtë në fushë, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Antetokounmpo për Bucksin. Rikthehet te fitorja ekipi i Lakersave,



që mundi 95-85 Houstonin, një ndeshje ku veteranët e ekipit kalifornian bënë diferencën në parket. Anthony realizoi 32 pikë, Westbrook 23, LeBron Jamesi 20 e

Davisi 15. Fitoi edhe Brooklynin që e mundi Detroitin pa problem 117-91, sfidë ku u dalluan Duranti me 23 pikë dhe Hardeni me një "triple double" (18 pikë, 10 rebounde, 12 asistime).

REZULTATET

Dallas - Sacramento	105-99
Charlotte - Portland	125-113
Milwaukee - Utah Jazz	95-107
Brooklyn - Detroit	117-91
Lakers - Houston	95-85

SHKURT

KB Peja suspendon basketbollistin Henrik Sirko

Skuadra e Pejës e ka suspenduar basketbollistin Henrik Sirko për sjellje jospportive në ndeshjen ndaj Yllit në Suharekë. "KB Peja njofton adhuruesit e saj se ka marrë vendim për suspendimin e lojtarit të saj Henrik Sirko. Suspendimi ka ardhur pas një incidenti pas ndeshjes mbrëmë në Suharekë, ku lojtari në fjalë ka shkelur rënd rregulloret dhe kodet e mirësjelljes së klubit tonë. Klubi ynë është i detyruar të marrë një vendim të tillë për t'i respektuar rregulloret tona dhe atmosferën e ekipit", thuhet në njoftimin e KB Peja.

Tottenhami shkarkon Santon, Conte mund të jetë trajner i ri

Tottenham Hotspuri e ka shkarkuar trajnerin Nuno Espirito Santo. Santo shkarkohet pas vetëm 17 ndeshjeve në krye të "Spurs". Humbja 0-3 nga Manchester Unitedi ishte vendimtare për të ardhmen e trajnerit Santo, i cili me gjasë do të zëvendësohet nga Antonio Conte. "Klubi konfirmon se Nuno Espirito Santo dhe stafi i tij i trajnerëve, Ian Cathro, Rui Barbosa dhe Antonio Dias, janë liruuar nga detyrat e tyre", thuhet në njoftimin e Tottenhamit.

PSG-ja mund të ndahet me Ramosin

Mbrojtësi Sergio Ramos u transferua me shumë bujë në Paris Saint-Germain, por ai mund të largohet shumë shpejt. "Le Parisien" raporton se skuadra e PSG-së e ka humbur durimin me mbrojtësin spanjoll i cili ende nuk ka debutuar për shkak të lëndimit. 35-vjeçari gjatë verës nga Real Madridi u transferua në PSG.

Pioli: Nuk jemi favoritë për 'Scudetto'

AC Milan e fitoi derbin ndaj Romës në Serinë A me rezultat 1-2, por trajneri Stefano Pioli është shprehur i matur me deklaratën e tij rreth favoritit për titull në Serinë A. Trajneri në fjalë ka thënë se Interi është favorit, por pas nuk janë as Napoli dhe Juventus. "Nuk e di sa superiorë jemi, por ky kampionat ka ekipe shumë të forta. Interi është favorit, Napoli është shumë i fortë dhe nuk mendoj se Juve është jashtë lojës. Sivjet jemi më të vetëdijshëm se jemi një ekip i fortë që mund të luajmë me mentalitetin tonë. Jemi të bindur se mund të fitojmë", ka thënë Pioli, i cili e ka lavdëruar edhe sulmuesin Zlatan Ibrahimović, duke thënë se sulmuesi me përvojën e madhe po e ndihmon ekipin të rritet.

Drejtori sportiv i Ferrarit: Jemi më afër Mercedesit dhe Red Bullit

Edhe pse Ferrari është ende jashtë "top-3" makinave më të mira të këtij sezoni të Formula 1, Mattia Binotto, drejtori sportiv i Ferrarit, shprehet i kënaqur me

paraqitjen e "kokëkuqes", sidomos në garat e fundit. Inxhinierët hera-herës sjellin disa modifikime në motorin e makinës italiane, që po rivalizon fort me McLaren për vendin e tretë.

Gjithsesi, për Binotto objektivi është ngushtimi i diferencës me Mercedesin dhe Red Bullin. "Tashmë motori ka një fuqi shtesë, që shihet sidomos në pjesët e drejta, në momentin kur

makina del nga kthesa etj. Nëse shihni garën e fundit në Austin, mund të shihni se makina jonë ishte e ngjashme me ato të tjerat që kryesonin garën për sa i përket shpejtësisë. Ky është

një hap shumë i madh krahasuar me sezonin e kaluar. Mendoj se tashmë diferenca mes nesh dhe Mercedesit e Red Bullit është ngushtuar shumë", ka thënë Binotto.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 dhe 10 par.2 nënparagrafi 2.3 të Ligjit të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullorës për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A, nenit 22 paragrafi 4 i Statuti të Trepça Sh.A, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe nevojës së paraqitur për plotësimin e vendit të punës në Terminalin Doganor, Trepça Sh.A me datë 02.11.2021 publikon këtë:

KONKURS

Pozita: Punëtor në Terminalin Doganor tre(3) pozita

Vendi i punës: Mitrovicë-Parku Industrial;

Kohëzgjatja e kontratës: me kohë ta pacaktuar;

Orari i punës: I plotë;

Kriteret dhe kualifikimi i kërkuar:

- Kandidati duhet të posedojë diplomën e shkollës së mesme;
- Kandidati duhet të posedoj njohuri të punës në kompjuter;

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Bën regjistrimin e kamionëve në hyrje dhe dalje në portën 2 dhe portën 3 në Terminalin Doganor të Trepça Sh.A.;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhërit të udhëheqësit të drejtëpërdrejt.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për pozitën Punëtor në Terminalin Doganor duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit);
- Certifikatën (dëshminë) nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në kopje elektronike në email adresën contact@trepcacorporation.com

Për informata shtese:

www.trepcacorporation.com si dhe e-mail

adresa: contact@trepcacorporation.com

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në web faqen e Trepça Sh.A. (www.trepcacorporation.com) dhe në shtypin ditor.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Winer PVC” SH.P.K. me pronar Xhevdet Ahmeti, rr. Analin Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 81859331, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Winer PVC” D.O.O. Xhevdet Ahmeti rr. Analin Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nr. 81859331 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Winer PVC” L.L.C. Xhevdet Ahmeti rr. Analin Vushtrri, has come to the decision to quit its business: nr. 81859331 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Neshat Elshani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

► Nik Spaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III. IV të Q.A.M.O. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

► Lumnije Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Avdyll Frasherit " Prizren.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Liridon Buqaj shpall te pavlefshme certifikatën shtetërore shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Ali Fanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Gjem Memqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pheter Budi " Lubizhd e Hasit.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Zbulim Kameri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e certifikatën e maturës të Gjinnazit “ Hajdar Dushi”.

► Egzona Hoti shpall të pavlefshme dëftesën e plot të shkollës SH.F.M.U. “Katër Dëshmorët” Retkoc Rahovec.


► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Zgjim Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit “Hajdar Dushi”.

► Rinor Musa shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit “Hajdar Dushi”.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Nik Spaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I. II. të Q.A.M.O. “Hajdar Dushi” Gjakovë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

QENDRA E KOMPETENCËS MALISHEVË

NJOFTIM

Qendra e Kompetencës në Malishevë njofton të gjithë operatorët ekonomik të cilë janë të interesuar për aplikim se:

Lëshohet në shfrytëzim (Qera), Restoranti i Qendrës së Kompetencës.

Të interesuarit materialin dhe informatat e nevojshme mund t'i marrin në zyrën nr.4 në objektin e QK-së nga data **02/11/2021 deri me datën 16/11/2021 prej orës 8:00-15:00**

Hapja e ofertave behet me daten 17/11/2021 nga ora 11:00.

Per informata shtese kontaktoni:

Xhevdet Krasnqi nr. i tel. 044/ 314-739

Nazmi Zogaj
Drejtor



Kriteret për dhënie në shfrytëzim të restorantit të Qendrës së Kompetencës – Malishevë

Të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë kualifikuar, do t'u nënshtrohen kriterëve të poshtë shënuara.

- Çmimi i qirasë së restorantit që pretendoni të paguani.
- Çmimet e produkteve të kuzhinës.
- **Kërkohej:** Lista e produkteve të kuzhinës që do të shërbehen në restorant dhe çmimet për secilin produkt, përfshirë edhe sasia e ushqimit që do të servohet, e matur me kilogram (kg., gr.).
- Të bëjë një ofertë me zbritje për stafin e mësimdhënësve.
- Ofrimi i një asortimenti të gjerë të produkteve
- **Kërkohej:** lista e produkteve të cilat do të shërbehen në restorant
- Cilësi e garantuar në produkte dhe shërbim
- **Kërkohej:** Kontrollimi i ushqimit në baza ditore për minimizimin e rreziqeve të helmimit dhe problemeve shëndetësore të nxënësit dhe stafit.
- Plotësimi i kërkesave të stafit në lidhje me produktet dhe shërbimet
- Cilësia e shërbimeve
- Dëshmia profesionale (certifikata, diploma) për fushën e hotelierisë të stafit të operatorit ekonomik
- Përvoja e punës në këtë fushë
- Kualifikimet e punëtorëve dhe të tjera... ju lutemi specifikoni nëse keni dëshmi të tjera profesionale.

Fituesi i tenderit do të përcaktohet nga kombinimi i pikëve të fituara për secilin kriter të lartshënuar. Operatori me numrin më të madh të pikëve totale do të jetë fituesi i tenderit.

Sukses!
Nazmi Zogaj
Drejtor



QENDRA E KOMPETENCËS MALISHEVË

Kriteret për qiradhënie e restorantit të shkollës

Qendra e Kompetencës në Malishevë posedon restorantin me të gjitha pajisjet më moderne nga fusha e gastronomisë. Kapaciteti i tij siguron plotësimin e nevojave dhe ditore për të gjithë stafin dhe nxënësit e shkollës.

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për stafin dhe nxënësit, Bordi i Qendrës së Kompetencës mori vendim në janar 2013 që, restoranti i shkollës ti jepet në shfrytëzim operatorit i cili i plotëson kriteret e poshtë shënuara.

Parakushtet për kualifikim:

- Operatori duhet të ketë biznesin e regjistruar ne Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe të jetë tatimpagues i rregullt në Administratën Tatimore të Kosovës.
- Operatori duhet të ketë traditë së paku 5 vjeçare në fushën e gastronomisë
- Të ketë të paguar tatimin në pronë
- Të ketë në stafin e tij punëtorë të kualifikuar/certifikuar në fushën e gastronomisë

Vërejtje: Për të gjitha parakushtet e lartshënuara kërkohet dëshmia dhe dokumentacioni plotësues! Operatorët ekonomik të cilët nuk i plotësojnë parakushtet, nuk do të kualifikohen në procesin e tenderimit!



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues